



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 594/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), për shkak të bërjes së fushatës gjatë ditës së zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), kështu që Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 200 (dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04. 11. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga BIRN, në të cilën theksohet se me datën 03.11.2013 Puhie Demaku kandidatë për asamble komunale në Prishtinë nga LVV ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë përmes postimit të një statusi dhe publikimin e një fotografie, andaj me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës ky veprim bie ndesh me dispozitat e LZP-së

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi LVV-në, me datën 05.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.11.2013, ora 10:00. PZAP-i sipas afatit të caktuar pranoi përgjigjen në ankesë nga LVV-ja e në të cilën theksohet fotografia e bashkangjitur ankesës nuk mund ta provojë autorësinë e postimit të fotografisë si dhe pronësinë ndaj llogarisë në rrjetin facebook të kandidatës së LVV-së. Poashtu sipas LVV-së shihet qartë se në fotografimin e ofruar si provë përfundim emërit të postuesit dhe kohës së postimit ku është 2 orë më parë është edhe një etiketim i ngjitur ku është shënuar data 3 nëntor 2013 ora 13:56 që aludohet se ky postim është postuar me 3 nëntor në ora 11:56 duke pasur se dy orë më parë është postuar para se ankuesi të ishte në dijeni lidhur me këtë postim, andaj kjo etiketë në asnjë mënyrë nuk e tregon se koha e postimit është autentike. Andaj mungesa e të provuarit të identitetit të pronësisë mbi llogarinë dhe kohës së postimit e bënë këtë ankesë si të pabazuar dhe si e tillë duhet ta hedhë poshtë. Me këtë rast LVV kërkon nga PZAP-i që ta merr parasysh se çështja e shtrirjes së legjislacionit në këtë sferë ku serverët e kompanisë facebook ku procedohen të dhënat softuerike gjendet në një shtet tjetër që në aspektin territorial legjislacioni i Republikës së Kosovës nuk vepron në hapësirë dhe se kjo është element kryesor i kualifikimit të veprimit të ligjit në hapësirë, kohë dhe ndaj personit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës shihet qartë se si kandidatja për asamble komunale në Prishtinë nga LVV-ja Puhie Demaku me datën 03 nëntor gjatë ditës së zgjedhjeve ka bërë postimin e fotografisë me katarakter zgjedhor me qëllim të favorizimit për tu votuar kandidati i LVV-së, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) të LZP-së e cilat përcaktonë që njëzetekatër (24) orë para hapjes së qendrave të voimit për hedhjen e votes e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mështetesve ose kandidateve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfardo mënyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i vlerëson se subjekti politik LDK në këtë rast ka thyer kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë. Andaj mbi këtë bazë si dhe në kuptim të nenit 36.1 pika b) dhe nenit 118.1 lidhur me neni 120 paragrafi 1 pika (c) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 594/2013 më datën 07.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*